



SHOQËRIA "REKOR ALBANIA" SH.A.

V E N D I M

I ASAMBLESË SË AKSIONARËVE

TË SHOQËRISË "REKOR ALBANIA" SH.A.

Sot më datën 28/06/2010, pranë hotel "Grand", Rr. "Ismail Qemali", Tiranë, u mbledh Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë, në të cilën ishin të pranishëm:

1. **Ioannis MAKRIS**, aksioner i shoqërisë i cili zotëron 62.44% të aksioneve të shoqërisë, i përfaqësuar me anë të Prokurës së datës 25 Qershor 2010, nga **Z.Kostantinos Iliopoulos**, shtetas grek, i biri i Panagiotis, lindur dhe banues në Athinë, më 01/01/1948, me Pasaportë me Nr.AB6630882, të lëshuar nga shteti grek.
2. "**Rekor Hellas**"SA, shoqëri tregtare greke, e cila zotëron 22.36% të aksioneve, me përfaqësues ligjor **Z.Ioannis Makris**, në bazë të Njoftimit Nr.2641 Prot., datë 24/05/2005, i cili përfaqësohet me Prokurën e datës 25 Qershor 2010 nga **Z.Kostantinos Iliopoulos**, me identitet si më sipër.

Aksioneri shtet i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, e cila zotëron 15.2% të aksioneve të shoqërisë, pavarësisht se ka marrë njoftim me anë të postës elektronike më datë 07/06/2010, njëkohësisht edhe dorazi pranë zyrës së protokollit të Ministrisë, nuk është i pranishëm në mbledhje, pa asnjë njoftim zyrtar. Aksionerët e tjerë të cilët zotërojnë 84.8% të aksioneve marrin vendim që mbledhja të zhvillohet pavarësisht mungesës së aksionerit shtet, duke qenë se nuk ka arsye ligjore për mungesën.

Pasi mori në shqyrtim rendin e ditës të caktuar nga Drejtori z.Leonidha Komino, si më poshtë vijon:

1. Miratimi i projektit të ndryshimeve në Statut konform kërkesave të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Per tregtare dhe shoqërit tregtare";
2. Zgjedhja e administratorit të shoqërisë "Rekor Albania"sha.;

K. Iliopoulos



3. Shqyrtimi i çështjes lidhur me padine e Drejtorisë rajonale të Tatimeve Gjirokastrë kundër shoqërisë "Rekor Albania" sha, për shpalljen e falimentimit të saj;
4. Miratimi i vendimit të Drejtorit Leonidha Komino për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa automjeteve të shoqërisë;
5. Informimi i Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e vendimit të saj për çuarjen për zgjidhje të konfliktit mes shoqërisë "Rekor Albania" sha dhe Shtetit Shqiptar në Arbitrazhin Nderkombëtar;
6. Të ndryshme.

KONSTATOI SE:

Shoqëria "REKOR ALBANI" sh.a., është një person juridik shqiptar, i regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr.

Shoqëria mori informacion nga Drejtori i shoqërisë lidhur me Vendimet e marra gjatë mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës të kësaj shoqërie, të datës 27/06/2010. Pasi u shqyrtuan dokumentat e paraqitura si dhe informacioni shtesë Mbledhja e Aksionarëve të Shoqërisë "REKOR ALBANIA" sh.a.

VENDOSI:

1. Duke marrë parasysh miratimin e llogarive nga ana e Këshillit Mbikqyrës, vendos që të miratojë llogaritë vjetore të vitit 2009 sipas dokumentacionit të paraqitur si: Bilancit Kontabël të ushtrimit 2009 së bashku me pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve e shënimet financiare, raportit të drejtimit si dhe raportit të auditimit nga eksperti kontabël i autorizuar.
2. Lidhur me shqyrtimin e projektit të ndryshimeve në Statut konform kërkesave të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", kjo pikë e rendit të ditës, në bazë të propozimit të Këshillit Mbikqyrës, do të shtyhet për një mbledhje tjetër. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve angazhohet që të

K. Ilieporos

zhvillojë një mbledhje tjetër sa më shpejt që të jetë e mundur, për të marrë në shqyrtim Projektin e Statutit.

3. Me vendimin e datës 27/06/2010, Këshilli Mbikqyrës, vendosi emërimin në postin e Administratorit të shoqërisë Z.Leonidha Komino. Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë vendos miratimin e këtij vendimi.
4. Shqyrtimi i çështjes lidhur me padinë e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokaster kundër shoqërisë "Rekor Albania" sha për shpalljen e falimentimit të saj. Avokati i shoqërisë lidhur me këtë pikë, i paraqiti anëtarëve një informacion verbalisht për sa i përket ecurisë. Kjo çështje është fituar në gjykatën e Shkallës së Parë dhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Aktualisht Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjistikës si dhe Avokati i Shtetit kanë paraqitur Rekurs përpara Gjykatës së Lartë. Shoqëria është në pritje të shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate.
5. U miratua kërkesa e Drejtorit të shoqërisë, Z.Leonidha Komino për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa automjeteve. Pas këtij vendimi këto automjete do të nxirren nga inventari i shoqërisë në përputhje me procesverbalet përkatëse.
6. Informimi i Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e vendimit të saj për zgjidhjen e konfliktit mes shoqërisë "Rekor Albania" sha dhe shtetit Shqiptar në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës, Z.Kostantinos Iliopoulos paraqiti një informacion të shkurtër. Aktualisht pritet që të përgatitet një Raport për Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjistikës si përpjekja e fundit për ta zgjidhur në mënyrë paqësore. Në rast se nuk merret asnjë zgjidhje shoqëria do t'i drejtohet Dhomës Ndërkombëtare të Arbitrazhit Tregtar në Uashington.
7. Z.Leonidha Komino në cilësinë e tij si Drejtor aktual i shoqërisë, i paraqet Këshillit Mbikqyrës propozimin për të zvogëluar kapitalin e regjistruar të shoqërisë, duke qenë se vlera reale e aktiveve të shoqërisë është më pak se gjysma e kapitalit të regjistruar. Këshilli Mbikqyrës e ka miratuar me unanimitet këtë propozim dhe ia ka kaluar për miratim Asamblesë së Aksionarëve. Asambleja e Aksionarëve vendos që ta shtyjë në mbledhjen tjetër më të afërt diskutimin lidhur me zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë.

K. Iliopoulos

8. Gjithë dokumentacioni i përgatitur për miratimin e vendimeve të mësipërme të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit sipas kërkesave të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe statutit të shoqërisë.

Këto vendime u miratuan unanimitisht nga aksionarët.

AKSIONARËT

Prof. Dr. Konstantina Iliopoulou

K. Iliopoulou

STATUTI

I SHOQËRISË ANONIME "REKOR ALBANIA" SH. A

KAPITULLI - I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Emërtimi

1. Emërtimi i shoqërisë është "Rekor Albania" sh.a Ky emërtim është i vetmi i saj dhe përdoret në të gjithë regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe ka vlefshmëri ligjore si jashtë ashtu edhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Shoqëria "Rekor Albania" sh.a është shoqëri aksionare me ofertë private.

Neni 2 Aksionarët

Janë aksionarë të shoqërisë në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme:

1. **Joannis Makris**, i biri i Georgios, i dl.3.6.1959, lindur ne Athine,Attikis, Greqi dhe banures po aty, i cili zotëron 62.44% të kapitalit, si rezultat edhe 62.44% të aksioneve të shoqërisë.
2. **Rekor Hellas**, person juridik tregtar, e cila është krijuar dhe funksionon në bazë të legjislacionit të shtetit grek, me përfaqësues ligjor **Z.Ioannis Makris**, në bazë të Njoftimit Nr.2641 Prot., datë 24/05/2005, e cila zotëron 22.36% të kapitalit, si rezultat edhe 22.36% të aksioneve të shoqërisë.
3. **Ministria e Tregtisë Ekonomisë dhe Energjetikës**, si përfaqësuese e Shtetit Shqiptar e cila zotëron 15.20% të kapitalit, si rezultat edhe 15.20% të aksioneve të shoqërisë.

Neni 3 Objekti i shoqërisë

1. Objekti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin aktual tregtar shqiptar do të jetë:
 - Prodhimi, përpunimi, tregtimi i lëkurave brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të vet apo të të tretëve;



- Prodhimi dhe përpunimi i gomës dhe produkteve plastike brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të vet apo të të tretëve;
- Prodhimi, tregtimi, eksporti dhe importi i këpucëve të çdo lloji;
 - Transport i të gjitha llojeve, brenda apo jashtë Shqipërisë, për llogari të vet apo të të tretëve.
 - Përfaqësimi në Shqipëri i shoqërive të huaja që prodhojnë apo tregtojnë njohuri teknike, përfshirë përfitimin dhe përdorimin e të drejtave ekskluzive dhe markave të regjistruara në përputhje me legjislacionin shqiptar.
 - Pjesëmarrja në shoqëri të tjera nëpërmjet krijimit të tyre, blerje apo shitje të kuotave të kapitalit të regjistruar, të Shoqërive që funksionojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.
 - Hapja dhe shfrytëzimi i dyqaneve, pikave të shitjeve, magazinave, etj., me qëllim tregtimin e produkteve të veta ose të të tretëve.
 - Të kryejë çdo aktivitet të ngjashëm apo në funksion të sa më sipër edhe nëse nuk është shprehimisht i parashikuar në këtë nen.
2. Përshkrimi i objektit të shoqërisë ka natyrë treguese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme në respektim të parimeve të së drejtës, ligjeve ndërkombëtare, ligjeve të shtetit shqiptar si dhe përcaktimeve të këtij Statuti.
 3. Shoqëria në çdo kohë mund të ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve të saj.

Neni 4

Selia e shoqërisë dhe degët

1. Selia e shoqërisë ndodhet në Rr. Nationale Gjirokastër Kakavijë, pranë Ish Fabrikës së Lëkurë Këpucëve Gjirokastër, Shqipëri.
2. Shoqëria ka të drejtë të operojë me degë apo zyra përfaqësimi, në të gjithë territorin e Shqipërisë apo edhe jashtë tij.
3. Degët apo zyrat e përfaqësimit krijohen me vendim të Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë, e cila organizon punën, përcakton mënyrën e funksionimit dhe emëron organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

1. Kohëzgjatja e shoqërisë anonime "REKOR ALBANIA" Sh.A. është 50 vjet dhe fillon në momentin e regjistrimit të Statutit të ri të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
2. Ky afat mund të zgjatet apo shkurtohet në çdo kohë me vendim të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve me të njëjtin kuorum që përcakton ligji tregtar për ndryshimin e statutit.

**KAPITULLI - II****KAPITALI I REGJISTRUAR, AKSIONET, AKSIONARËT****Neni 6
Kapitali i regjistruar**

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është: 1.538.923.0000 lekë.
2. Numri i aksioneve të shoqërisë që i përgjigjet kapitalit në fjalë është: 100
3. Vlera nominale e secilit aksion është 15.389.230 lekë.

**Neni 7
Ndryshimi i kapitalit të regjistruar**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të shtohet apo të pakësohet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve. Në çdo rast, ndryshimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë duhet të jetë i arsyetuar dhe i shoqëruar me relacionin e Ekspertit Kontabël të shoqërisë.

**Neni 8
Zmadhimi kapitalit të regjistruar**

1. Zmadhimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë bëhet në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - me emetimin e aksioneve të reja, duke shtuar numrin e aksioneve që përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë pa ndryshuar vlerën nominale të aksionit.
 - me rritjen e vleres nominale të çdo aksioni pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të tyre.
2. Kompetente për caktimin e mënyrës së shtimit të kapitalit të regjistruar është asambleja e përgjithshme pasi merr në shqyrtim relacionin e ekspertit kontabël të autorizuar.
3. Aksionet e reja shlyhen me para në dorë, me kompesim të një kredie të kërkueshme të shprehur në para, me përfshirje të rezervave, fitimeve apo primeve, apo me kontribut në natyrë.
4. Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkuara më parë.

**Neni 9
E drejta e parablerjes**

1. Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për aksionet e emetuara rishtazi, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar, që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet jo më vonë se 20 ditë pas publikimit në QKR të vendimit të asamblesë së përgjithshme për zmadhimin e kapitalit.



2. Të drejtat e përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të kufizohen ose të përjashtohen nga vendimi i asamblesë së përgjithshme për zmadhimin e kapitalit.

Neni 10

Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë

1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
2. Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar ose përtej një vlere më të lartë të rezervës së përcaktuar në statut, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin e regjistruar.
3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin e regjistruar, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.
4. Aksionarët kanë të drejtë të zotërojnë aksionet e emetuara rishtazi në përpjesëtim me përqindjen e zotërimit të aksioneve në shoqëri, përpara rritjes së kapitalit. Çdo vendim i asamblesë së përgjithshme, që bie ndesh me këtë dispozitë, është i pavlefshëm.

Neni 11

Kontributet në natyrë

1. Në rast se asambleja e përgjithshme e aksionarëve vendos që zmadhimi i kapitalit do të kryhet me kontribute në natyrë, caktohen me vendim gjyqësor një ose disa ekspertë për përcaktimin e vlerës së kontributeve. Raporti i ekspertëve vihet në dispozicion të aksionarëve të paktën 10 ditë pune përpara mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.
2. Në rast se asambleja e përgjithshme e aksionarëve miraton vlerësimin e kontributeve ajo merr njëkohësisht vendimin për evidentimin e shumës së rritjes së kapitalit të regjistruar.
3. Në rast se asambleja e aksionarëve zvogëlon vlerën e përcaktuar nga eksperti atëherë ajo kërkon miratimin me shkrim të kontribuesit në natyrë apo përfaqësuesit të tij ligjor, në të kundërt zmadhimi i kapitalit nuk realizohet.

Neni 12

Pakësimi i kapitalit të regjistruar

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, vetëm pasi të jetë shqyrtuar paraprakisht relacioni i Ekspertit Kontabël të Autorizuar lidhur me këtë çështje.
2. Në të gjithë rastet zvogëlimi i prek aksionarët në të njejtën masë në përpjestim me përqindjen e zotërimit të aksioneve në shoqëri.
3. Kapitali i regjistruar nuk mund të pakësohet poshtë kufirit minimal ligjor të parashikuar në ligjin tregtar për shoqëritë aksionare me ofertë private.

Neni 13
Regjistrimi dhe publikimi i rritjes së kapitalit

1. Administratori i shoqërisë duhet të njoftojë për regjistrim pranë QKR-së vendimin për zmadhimin e kapitalit.
2. Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit, administratori i njofton QKR-së realizimin e këtij veprimi. Informacioni shoqërues duhet të përfshijë listën e personave, që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumat e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga administratori.
3. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në QKR.

KAPITULLI III

DREJTIMI I SHOQËRISË


Neni 14
Organet Drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë aksionare "Rekor Albania"sha, janë të organizuara sipas sistemit me dy nivele. Këto organe konkretisht janë si më poshtë:

- a) Asambleja e Përgjithshme.
- b) Këshilli Mbikëqyrës.
- c) Administratori i Shoqërisë.

Neni 15
Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

1. Asambleja e Aksionarëve është organi më i lartë drejtues i shoqërisë dhe ka të drejtë për të vendosur në lidhje me të gjithë çështjet e shoqërisë. Ajo ka të drejtë të shqyrtojë vlefshmërinë e çdo vendimi të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Administratorit dhe t'i anulojë ato kur e sheh të arsyeshme, apo kur nuk janë në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Asambleja e Aksionarëve përfaqëson totalin e kapitalit të shoqërisë dhe vendimet e saj detyrojnë dhe angazhojnë të gjithë aksionarët, edhe kur ata nuk janë pjesëmarrës në vendimmarrje apo janë shprehur kundër vendimeve të Asamblesë.
3. Asambleja e Aksionarëve mundet në çdo kohë të revokojë vendimet e saj kur ato nuk janë regjistruar ende në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.





Neni 16 **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Të drejtat e aksionereve ushtrohen nepermjet Asamblesë se Përgjithëshme.
2. Asambleja e Përgjithëshme merr vendime per  eshtjet e meposhtme te shoq ris :
 - a) p rcaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshimin e statutit;
 - c) em rimin dhe shkarkimin e K shillit Mbikqyr s dhe t  administratorit;
 - d) em rimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspert ve kontab l t  autorizuar;
 - dh) miratimin e skemes se shperblimeve te personave te percaktuar ne germat c-d;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecuris se veprimtaris;
 - f) shp rndarjen e fitimeve vjetore;
 - g) zmadhimin dhe zvog limin e kapitalit t  regjistruar;
 - h) pjestimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - i) p rfaq simin e shoq ris  ne gjykimet ndaj organeve t  administrimit;
 - j) riorganizimin dhe prishjen e shoq ris ;
 - k) miratimin e rregullave procedurjale t  mbledhjeve t  saj;
 - l)  shtje te tjera te parashikuara nga ligji apo Statuti.
3. Asambleja e P rgjithëshme merr vendime pas shqyrtimit t  dokumentave p rkat se s  bashku me raportin e K shillit Mbikqyr s dhe raportin e ekspertit kontab l t  autorizuar.

Neni 17 **Shoq ria me n  aksionar t  vet m**

N se shoq ria zot rohet nga n  aksionar, t  drejtat dhe detyrimet e asambles  s  p rgjithshme ushtrohen nga aksionari i vet m. T  gjitha vendimet e marra nga aksionari i vet m regjistrohen n  n  regjist r t  vendimeve, t  dh nat e t  cilit nuk mund t  ndryshohen ose t  fshihen. Duhet regjistruar n  veqanti, por pa u kufizuar n  to, vendimet e m poshtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe t  raporteve t  ecuris  s  veprimtaris ;
- b) shp rndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvog limi i kapitalit;
-  ) vendimet p r investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoq ris .

Vendimet e paregjistruara n  regjistrimin e vendimeve jan  absolutisht t  pavlefshme.

Neni 18 **Mbledhja e Asambles  se P rgjith shme**

1. Mbledhja e zakonshme e Asambles  s  P rgjith shme thirret t  pakt n n  her  n  vit.



2. Asambleja e Përgjithëshme thirret nga administratori, nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, apo nga aksionarët në rastet e parashikuara nga neni 139 i ligjit për shoqëritë tregtare.
3. Asambleja e Përgjithëshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet që janë të kërkueshme brenda tre muajve në vijim.
4. Asambleja e Përgjithëshme duhet të mbledhet kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, nëse kjo rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara. Pika 4 e nenit 13 të ligjit për shoqëritë tregtare zbatohet në rast se veprimi do të kryhet nga personat e percaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 13 të ligjit për shoqëritë tregtare.
5. Sipas rastit zbatohen edhe pikat e tjera të nenit 136 të ligjit.

Neni 19

Menyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithëshme

- Asambleja e Përgjithëshme thirret me njoftim me shkrim ose me mesazh elektronik, duke ju derguar të gjithë aksionarëve rendin e ditës, jo më pak se 21 ditë përpara mbledhjes.
- Njoftimi duhet gjithashtu të përmbajë:
 - a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, datën, vendin dhe orën e mbledhjes;
 - b) të drejtat e aksionarëve sipas nenit 139 të ligjit për shoqëritë tregtare;
 - c) procedurat e votimit me prokurë, formularët e posaçëm për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe me mjete elektronike;
 - e) procedurat e votimit me mjete elektronike apo me korespondencë;
 - f) informacion për vendin ku mund të merret dokumentacioni dhe projekt vendimet.
 - g) adresën e faqes së internetit të shoqërisë.

Njoftimi dhe rendi i ditës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithëshme vendosen edhe në faqen e saj të internetit.

Zbatohen edhe pikat e tjera të nenit 137 të ligjit për shoqëritë tregtare

Neni 20

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës që njoftohet sipas nenit 19 të statutit duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.
2. Nëse do të propozohen ndryshime në statut duhet të paraqitet edhe teksti i ndryshimeve.
3. Aksionarët që kërkesë për sqarim duhet ta dergojnë 8 ditë para mbledhjes dhe administratori është i detyruar të përgjigjet me shkrim për çdo kërkesë.
4. Kur nuk respektohen formalitetet për thirrjen e Asamblesë së Përgjithëshme, vendimet e marra janë të vlefshme nëse të gjithë aksionarët janë prezent dhe i votojnë ato.
5. Për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme dhe rendin e ditës të kërkuar nga aksionarët e pakicës respektohen kërkesat e nenit 139 të ligjit për shoqëritë tregtare.



Neni 21
Përfaqësimi në Asamblenë e Aksionarëve

Për mënyrën e përfaqësimit në Asamblenë e Përgjithëshme zbatohen kriteret e nenit 140 të ligjit për shoqëritë tregëtare.

Neni 22
Pjesmarrja në mbledhjen e asamblese

1. Asambleja e Përgjithëshme cakton një kryetar.
2. Gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithëshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe përfaqësuesve të tyre, shënohen emrat dhe adresat e tyre, së bashku me numrin e aksioneve, përqindjen e votave që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion të gjithë aksionarëve dhe nënshkruhet prej tyre.
3. Aksionarët kanë të drejtë që në marreveshje me shkrim të bien dakort që çdo vendim që do merret, të merret unanimisht.
4. Nëse lind nevoja mund të zbatohen edhe pikat e parashikuara në nenin 142 të ligjit për shoqëritë tregëtare.

Neni 23
Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë

1. Te gjitha vendimet e mbledhjes së Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e tij.
2. Procesverbalit duhet të përmbajë: datën e mbledhjes, vendin, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen qëndrimin e aksionerëve kundër.
3. Procesverbalit i bashkalidhet lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë. Procesverbalit dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.
4. Jo më vonë se 15 ditë nga dita e mbledhjes, administratorët janë të detyruar që të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithëshme të Aksionarëve në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 24
Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve që vendosen me shumicë të zakonshme votash, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionerët që zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve me të drejtë vote.



2. Kur asambleja duhet te vendosë për çështje që kerkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 te ligjit per shoqeritë tregtare, Asambleja e Përgjithëshme mund te marre vendime te vlefshme vetëm në se Aksionarët qe zotërojnë me shume se gjysmen e numrit total te aksioneve me te drejtë vote apo perfaqesuesit e tyre, marrin pjesë ne votim personalisht ose votojnë me shkresë apo mjete elektronike sipas kerkesave te nenit 142 te ligjit per shoqerite tregtare.
3. Ne se Asambleja e Përgjithëshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi, asambleja mblidhet perseri jo me vonë se 30 ditë me te njejtin rend ditëe.
4. Asambleja vendos me $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e votave qe marrin pjesë ne votim per ndryshime ne statut, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
5. Asambleja merr vendim me shumicen e votave te aksionereve qe marrin pjesë ne mbledhje per çështjet e renditura ne nenin 135 të ligjit per shoqeritë tregtare.
6. Kur Asambleja merr vendim per detyrime shtesë mbi Aksionarët apo vendime që kufizojnë të drejtat e tyre, vendimet quhen të vlefshme kur miratohen nga aksioneri përkatës.
7. Në çdo rast quorumi verifikohet para fillimit të mbledhjes nga drejtuesi i mbledhjes.

Neni 25 Marrja e vendimeve

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime nëpërmjet votimit të hapur.
2. Per emërimin apo shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikqyres apo të administratorit, Asambleja vendos me votim te fshehtë vetem ne se kerkohet nga aksionerët qe zotërojnë te pakten 5% te kapitalit te regjistruar te shoqërisë.

Neni 26 Pjesëmarrja ne votim

Aksioneri nuk mund te ushtroje te drejten e votes nëse Asambleja e Përgjithëshme duhet te marre vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarisë se tij;
- b) faljen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e ndonje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Ky ndalim aplikohet edhe në rastin e përfaqësimit me autorizim të aksionerit.

Neni 27 Organizimi i Mbledhjes së Asamblesë nëpërmjet videokonferencës

1. Me miratimin e aksionarëve që zotërojnë $\frac{1}{2}$ (nje te dyten) e aksioneve mund të lejohet pjesëmarrja e një ose disa aksionarëve në mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet



videokonferencës së drejtpërdrejt, duke iu dhënë mundësi aksionarëve të shprehen në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme në kohë reale, nga një vendndodhje tjetër.

2. Mbledhja do të jetë e vlefshme vetëm nëse janë marrë të gjitha masat teknike që të gjithë pjesëmarrësit të mund të kenë mundësi komunikimi të drejtpërdrejt me të gjithë pjesëmarrësit e tjerë.
3. Kur mbledhja organizohet me pjesëmarrjen e një ose disa aksionarëve me videokonferencë është e domosdoshme që çdo vendim të merret në praninë e një Noteri Publik i cili të mund të vërtetojë edhe vërtetësinë e nënshkrimeve elektronike.
4. Nënshkrimi elektronik do të përdoret brenda rregullave të përcaktuara në ligjet përkatëse që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
5. Në rast paqartësish në çdo rast do të zbatohen dispozitat e nenit 142 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 28 Hetimet e posaçme

1. Asambleja mund të vendos të nis një hetim të posaçëm për parregullsi të ushtrimit të veprimtarisë tregtare duke caktuar një ekspert të pavarur të fushës përkatëse.
2. Edhe Aksionarët e pakices dhe kreditorët mund t’i kerkojnë Asamblesë së Përgjithëshme emërimin e një eksperti kur ka dyshime për parregullsi.
3. Në se Asambleja e refuzon kerkesen, ata kanë të drejtë t’i drejtohen gjykatës brenda 30 ditëve nga rrefuzimi për të caktuar një ekspert për hetimin e parregullsisë.
4. Në këtë rast zbatohen edhe kriteret e tjera të nenit 150 të ligjit për shoqëritë tregtare.
5. E drejta për të kerkuar hetim të posaçëm parashkruhet me kalimin e tre vjeteve nga data e veprimit.

Neni 29 Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe demshperblimi

1. Asambleja e Përgjithëshme ka të drejtë t’i kerkojë gjykatës të shfuqizojë vendimin e Administratorit apo të Këshillit Mbikqyres kur vëren shkelje të rënda të ligjit dhe të Statutit.
2. Në varesi nga organi i përcaktuar në pikën një, vendimi i të cilit paditet, Asambleja merr pjesë në gjykim nëpërmjet administratorit, këshillit mbikqyres ose një përfaqësuesi të posaçëm të caktuar nga asambleja e Përgjithëshme.
3. Zbatohen edhe kërkesat e tjera të nenit 151, 152 dhe 153 të ligjit për shoqëritë tregtare.



Neni 30
E drejta e votës

Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e një vote. Aksionarët shprehin me votën e tyre vetëm një qëndrim për të gjitha aksionet që zotërojnë. Totali i aksioneve që zotëron një aksionar nuk mund të ndahet për efekt votimi në pjesë.

Neni 31
Kontrolli financiar i Asamblesë

1. Këshilli Mbikqyrës i paraqet asamblesë së aksionarëve llogaritë vjetore dhe kur është rasti llogaritë e konsoliduara.
2. Ekspertët kontabël parqesin përpara asamblesë së aksionarëve kryerjen e detyrave të tyre të ngarkuara sipas ligjit.
3. Asambleja e aksionarëve shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet financiare të vitit të kaluar.

Neni 32
Administratori

1. Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga nje administrator i cili zgjidhet nga Asambleja e Përgjithëshme për nje periudhe 3 – vjeçare (tre) me te drejtë rizgjedhje të pakufizuar.
2. Administrator i Shoqërisë është Z. Leonidha KOMINO.
3. Me vendim te Asamblesë mund te caktohen edhe dy administratore.
4. Administratori drejton shoqërinë dhe merr vendime për mbikqyrësin e regullt të shoqërisë dhe zhvillimin normal të veprimtarisë së saj tregtare.
5. Administratori mund të shkarkohet vetëm nga Asambleja e Përgjithëshme
6. Administratori kryen funksionet e përcaktuara në pikat 3, 4, dhe 5 të nenit 158 dhe shkronjat “a”, “gj”, “h”, e “i” të pikës 1 të nenit 154 të ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
7. Dispozitat e neneve 154 deri 165 të këtij ligji gjejnë zbatim edhe për marrdhëniet midis administratorit dhe këshillit mbikqyrës mbasi funksionet e këshillit mbikqyrës i korespondojnë ato të këshillit të mbikqyrësit sipas nenit 167 po të këtij ligji.
8. Administratori nuk mund të zgjidhet Anëtar i këshillit mbikqyrës.

Neni 33
Këshilli Mbikqyrës

1. Këshilli Mbikqyrës zgjidhet nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për shoqëritë tregtare. Zgjedhja e tyre bëhet për një periudhë trevjeçare me të drejtë rizgjedhje.



2. Këshilli Mbikqyrës zgjedh një kryetar dhe një zvendës me shumicë votash dhe me votim të hapur.
3. Numri i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është 5 (pese).
4. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë të pavarur.
5. Aksionarët e pakicës kanë të drejtë të zgjedhin një anëtar të këshillit mbikqyrës.
6. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk duhet të kenë konflikt interesi, në bazë të kritereve të të pikes 3 të nenit 13 të ligjit për shoqëritë tregtare.
7. Këshilli Mbikqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikën 1, shkronjat “g” e “I” dhe pika 2 e nenit 154 të ligjit 9901 dat 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
8. Parashikimet e neneve 155 dhe 157 të ligjit për shoqëritë tregtare zbatohen edhe për Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, me përjashtimet e përcaktuara në nenin 167, pika 4 të këtij ligji.
9. Kriteret e neneve 160, 161, 162 të këtij ligji zbatohen edhe për shpërblimin, organizimin e brendshëm dhe marrjen e vendimeve nga këshilli mbikqyrës.
10. Këshilli Mbikqyrës mblidhet të paktën një herë në tre muaj me njoftim me shkrim të Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës. Se bashku me njoftimin antareve ju dërgohet edhe rendi i ditës, data dhe vendi i mbledhjes.

Neni 34

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Administratori dhe anëtarët e këshillit mbikqyrës përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.
2. Administratori apo anëtarët e këshillit mbikqyrës, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në nenin 163 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” janë të detyruar t’i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t’i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori apo anëtarët e këshillit mbikqyrës kanë barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një anëtar i këshillit mbikqyrës, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

KAPITULLI IV

EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR .

Neni 35

Ekspertët Kontabël

1. Shoqëria duhet të ketë të paktën një ekspert kontabël të përhershëm. Eksperti kontabël caktohet nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve, me vendim të marrë me shumicë të thjeshtë, dhe duhet të plotësojë kushtet e nevojshme ligjore për të qenë i tillë.



2. Asambleja mund të marrë vendim që të caktojë më shumë se një ekspert kontabël, të cilët duhet të veprojnë bashkarisht.
3. Eksperti/ët emërohen për një vit ushtrimor me te drejtë të rinovimit të mandatit të emërimit për çdo vit financiar nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve.
4. Çdo aksionar ka të drejtë që në rastet kur shoqëria mbetet pa ekspert kontabël apo ligji kërkon emërimin e një eksperti tjetër dhe ky detyrim nuk është plotësuar nga asambleja, t'i kërkojë gjyaktës caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar në rrugë gjyqësore.
5. Eksperti apo Ekspertët Kontabël të shoqërisë thirren në mbledhjen e këshillit mbikqyrës që vendos për mbylljen e llogarive të vitit financiar si dhe në të gjitha mbledhjet e asamblesë së aksionarëve.
6. Eksperti kontabël i shoqërisë është i detyruar të ruajë sekretet për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit dhe është përgjegjës për dëmet që i shkakton shoqërisë nga veprimet apo mosveprimet me faj të tij.

Neni 36

Detyrat e ekspertit kontabël

Eksperti kontabël i autorizuar garanton rregullshmërinë e llogarive vjetore dhe të gjendjes financiare të shoqërisë, verifikon librat e llogarisë dhe fondet e shoqërisë, kontrollon bilancin e shoqërisë, përshtatjen e kontabilitetit me legjislacionin në fuqi dhe siguron që të jetë respektuar barazia midis aksionarëve, si dhe çdo detyrë tjetër që rrjedh shprehimisht nga ligji tregtar shqiptar apo i ngarkohet me vendim të asamblesë.

Neni 51

Informimi i organeve të shoqërisë

Eksperti kontabël i autorizuar u bën të njohur këshillit mbikqyrës dhe Adminsitratorit:

- a) Kontrollat që ka kryer dhe verifikimet që ka bërë;
- b) Pjesët e bilancit dhe dokumentave kontabël në të cilat duhet të bëhen ndryshime së bashku me vërejtjet përkatëse;
- c) Parregullshmëritë dhe pasaktësitë e zbuluara;
- d) Përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigjimet të krahasuara me rezultatet e vitit financiar të mëparshëm.

Neni 37

Të drejtat e ekspertit

Eksperti përveç sa i njihet nga ligji për ushtrimin e detyrës ka të drejtë që:

- a) Në mbarim të afatit të funksioneve apo kur është propozuar shkarkimi i tij, të dëgjohej nga mbledhja e asamblesë së aksionarëve.



c) Eksperti kontabël ka të drejtë që për çështje në të cilat është drejtpërdrejtë përgjegjës t'i kërkojë këshillit mbikqyrës apo administratorit të Përgjithshëm të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve. Këshilli i mbikqyrësit është i detyruar që brenda 10 ditëve të fillojë procedurat e thirrjes.

Neni 38 **Shpërblimi i Ekspertëve Kontabël**

Shpërblimi i ekspertëve kontabël caktohet nga këshilli i mbikqyrësit mbi bazë mujore apo për çdo shërbim, parashikohet si shpenzim i veçantë dhe përballohet nga shoqëria.

Neni 39 **Ushtrimi i vitit financiar**

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 40 **Raportet Vjetore**

1. Në mbylljen e çdo viti financiar Administratori harton një raport me shkrim për Këshillin e Mbikqyrësit, së bashku me inventaret dhe llogaritë vjetore.
2. Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, çdo informacion të rëndësishëm, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme, etj.
3. Një kopje e këtij raporti i jepet Ekspertit Kontabël për miratim.

Neni 41 **Rezultatet e ushtrimit dhe caktimi i fitimeve**

1. Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, duke përfshirë te këto të fundit amortizimet dhe provizionet.
2. Shuma e fitimeve të mbetura pas heqjeve për krijimin e rezervave përfaqëson dividendin, i cili i shpërndahet ndërmjet aksionarëve në përputhje me pjesët e tyre, në rast se asambleja e aksionarëve nuk vendos për rritjen e kapitalit.
3. Duke përjashtuar rastin kur është vendosur zvogëlimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk bëhet asnjë heqje dhe asnjë derdhje dividenti, në qoftë se kapitalet e veta janë ose do të beheshin më të vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumën minimale të kërkuar për rezervën e domosdoshme.
4. Në qoftë se ekziston një humbje, kjo mbartet për t'u përfshirë në fitimet e ushtrimit të viteve ardhshme deri në shuarjen e saj.



KAPITULLI V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42

Likuidimi i shoqërisë

1. Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, apo pas mbarimit të afatit të përcaktuar, në atë rast kur nuk vendoset zgjatja e aktivitetit të shoqërisë, Asambleja e aksionëreve cakton dy likuidatorë, kompetencat e tyre dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar.
2. Likuidatorët e emëruar nga Asambleja menjëherë sapo marrin detyrën janë të detyruar të publikojnë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe ti vënë në dispozicion të aksionarëve me kërkesën e tyre.
3. Me caktimin e likuidatorëve pezullohen të gjitha kompetencat e administratorit dhe ato u kalojnë likuidatorëve.
4. Gjatë procesit të likuidimit aksionarët ruajnë të njëjtat të drejta informimi si dhe më parë.

Neni 43

Dispozita të fundit

1. Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "**Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**", si dhe të ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007, "**Për qendrën kombëtare të regjistrimit**".
2. Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me ligj tregtar nënkuptohet ligji nr. nr.9901, datë 14.4.2008, "**Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**".
3. Pavlefshmeritë e dispozitave të veçanta të Statutit nuk çenojnë vlefshmërinë e tërësisë së tij.

Neni 44

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast të një mosmarrëveshjeje ndërmjet aksionarëve apo organeve drejtuese të shoqërisë, palët do të mundohen me të gjitha mënyrat që ta zgjidhin me mirëkuptim.
2. Në rast se mosmarrëveshja nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim dhe aksioneri i huaj ka pretendime që lidhen me një qëndrim diskriminues, me një shpronësim në dem të investitorit të huaj, për kompensim të padrejtë etj., në zbatim edhe të kërkesave të nenit 8 të ligjit 7764 datë 2.11.1993 "**Për investimet e huaja**", kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Qendra Ndërkombëtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes shteteve dhe investitorëve të shteteve të tjera, në përputhje me konventën e 18 marsit të vitit 1965 të Uashingtonit e nënshkruar edhe nga Republika e Shqipërisë.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot date 11 prill 2011 (dymije e njembedhete), dite e hene, para meje Noteres Alma I. POSHI, me seli ne adresen: Rr. Sulejman DELVINA, Nd. 45, H. 7, Ap. 2, Nj. Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1022, TIRANE, u paraqit:

- 1. Ioannis MAKRIS**, i biri i Georgios, lindur me 03.06.1959 ne Athine – Attikis, Greqi, banues po aty, me adrese: N. Χαλκηδονας Αττικής, Περισους (Perisou) nr. 65, mbajtes i Pasaportes Greke AB8932335 / Ieshuar N.P.C date 04 Maj 2007 e vlefshme deri me 03 Maj 2012, **zoterues i 62,44 %** te kapitalit te Shoqerise, dhe
- 2. Rekor Hellas SA**, zoterues i **22,36 %** te kapitalit te Shoqerise, me perfaqesues ligjor Ioannis MAKRIS, me identitet si me siper,

persona madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me cilesine e Anetareve/Aksionere **te Shoqerise "REKOR ALBANIA" Sh.a. deklaruan se Statuti i Shoqerise me perditetimet e ndodhura ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"**, bashkangjitur, redaktuar jashte kesaj zyre noteriale, shpreh vullnetin e tyre te lire e te plote duke e nenshkruar ate rregullisht para meje noteres.

Per shtetasin grek Ioannis MAKRIS, sa me siper u perkthye nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe dhe nga gjuha shqipe ne gjuhen angleze nga perkthyesja e gjuhes angleze Adriana Dervishaj, e njohur personalisht prej meje noteres.

Une noteri, legalizoj nenshkrimin e tyre bazuar ne nenin 39/c te Ligjit "Per Noterine".

NOTERE

Alma Poshi